



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI PORTUAL DURRËS

Nr ____ Prot

Durrës, më . . .2024

FTESË PËR OFERTË

Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor

Emri Autoriteti Portual Durrës
Adresa Lagjia nr 1,Rruga Tregtare,Durrës
Tel/Fax +355 52 2 23115
E-mail e.ramaliu@durresport.al
Adresa e Internetit www.durresport.al

Autoriteti kontraktor do të zhvillojë procedurën e prokurimit për blerjen e biletave të transportit ajror ndërkombëtar me itinerar TIRANË – ROMË -TIRANË

Data e zhvillimit do te jetë 22. 02.2024, ora 11.30 , në adresën www.app.gov.al.

Jeni të lutur të paraqisni ofertën tuaj për këtë objekt prokurimi me këto të dhëna:

Itinerari “TIRANË – ROMË – TIRANË” , me detajet si më poshtë:

- Nisja nga Tirana me datë 28.02.2024 , , në orën 6.10 a.m, fluturim direkt
- Kthimi nga Roma me datë 01.03.2024, nisja nga Roma jo më herët se ora 10.00 p.m ,fluturim direkt
- Udhëtim për 1 (një) person.
- Përfshirja në çmim e një cantë shpine (8 kg) dhe një bagazh dorë (10) kg si në vajtje dhe në ardhje.

Operatori ekonomik i renditur i pari, përpara se të shpallet fitues,duhet të dorëzojë nëpërmjet sistemit të prokurimit elektronik, dokumentet si më poshtë:

Rezervimin e biletës,sipas destinacionit të kërkuar;

Rezervimi duhet të paraqitet brënda 2 orëve nga shpallja e fituesit.

Operatori ekonomik duhet të ketë në objektin e ushtrimit të veprimtarisë së tij sipas dokumentit të lëshuar nga QKB objektin që po prokurohet. Nuk është e nevojshme paraqitja e dokumentit të QKB pasi APD do te kryej vetë verifikimet e nevojshme. Mos përputhja e fushës së veprimtarisë me objektin që po prokurohet do të jetë kusht për skualifikim.Ne ofertën e tij, ofertuesit duhet të paraqesë te dhënat e plota të personit të kontaktit.

Shënim: Operatori ekonomik fitues për nënshkrimin e një kontrate / dorëzimin e faturës tatimore duhet të ketë:

- Kopje të Certifikatës elektronike për Fiskalizimin, për tatimpaguesit që përdorin Platformën Qëndrore të Faturave.

- Kopje të Certifikatës elektronike për Fiskalizimin dhe Kopje të vlefshme të Kontratës së lidhur me Shoqërinë e Certifikuar për zgjidhjen softëer-ike në përdorim, për tatimpaguesit që lëshojnë faturat nëpërmjet zgjidhjes softwer-ike.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV

Pirro Vengu

